

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e disa kërkesave për regjistrim si subjekt zgjedhor nga disa parti politike, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu, znj. L. Dulo.
- Parti Politike:** KEA (z. I. Sako)
- Të tjerë:** KRIIK.

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme publike kemi për shqyrtim disa kërkesa të disa partive politike për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025. Po Licela!

Znj. L. Veliu: Në kuadër të procesit të regjistrimit si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025, kanë depozituar pranë KQZ-së kërkesat e tyre partitë politike si vijon:

Partia Aleanca Demokracia e Re, me kryetar Edmond Stojku;

Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, me kryetar Eduart Abazi;

Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë, me kryetar Rivelino Çuno;

Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, me kryetar Krenar Rryçi;

Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, me kryetar Gjet Ndoj;

Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, me kryetar Gaqo Apostoli;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 26.02.2025*

Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, me kryetar Selami Jenishehri;
Partia Ardhmërija Shqiptare, me kryetar Emin Subashi;
Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, me kryetar Valentino Mustaka;
Partia “Djathtas 1912”, me organ drejtues “Kolegji Politik”;

Bashkëlidhur kërkesës nga secila parti politike është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në referim të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimit nr. 2 i datës 22 janar 2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë së datës 11 Maj 2025”. Bazuar në shqyrtimin dhe verifikimin e kryer dokumentacioni shoqërues i paraqitur nga partitë politike është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar. Gjithashtu në lidhje me partinë politike “Koalicioni Euroatlantik”, me kryetar Endri Hasa, informojmë sa më poshtë: Në datë 24 shkurt 2025 është depozituar pranë KQZ-së kërkesën për të regjistruar partinë politike “Koalicioni Euroatlantik” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025. Për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor bazuar në nenin 64, pika 2, germa “a”, nevojitet vërtetimi i regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe zoti Endri Hasa, ka paraqitur Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 14.02.2025 i cili nuk ka marrë formë të prerë.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Kishit diçka për këtë? Po!

Z. I. Sako, përfaqësues i KEA: Faleminderit i nderuar, Kryetar! Unë jam Ibrahim Sako, përfaqësues i subjektit politik Koalicioni Euroatlantik. Bazuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor, brenda afateve ligjore, kemi depozituar pranë protokollit të KAZ,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 26.02.2025*

kërkesën për regjistrim të subjektit politik Koalicioni Euroatlantik. Ashtu siç dhe specialistia parashtroi, është e vërtetë që vërtetimi i gjykatës nuk ka marrë ende formë të prerë, duke qenë se subjekti ynë politik ka bërë disa ndryshime. Gjykata me vendimin nr. 6 të datës 14 shkurt 2024 ka marrë vendim dhe ka konstatuar ndryshimet përkatëse, bazuar në kërkesën që ne kemi bërë. Duke qenë se pati ndryshime në Kodin Zgjedhor dhe afatet u afruan, ne jemi të pamundur në këtë moment që të marrim vendimin e formës së prerë. Në kërkesën që kemi dorëzuar kemi bashkangjitur vërtetimin ku thuhet vendimmarrja e gjykatës dhe të gjitha ndryshimet që subjekti politik ka bërë në vite. Gjithashtu dhe një vërtetim sipas gjendjes aktuale që figuron me emrin Partia Konservatore. Duke qenë se vendimi për ne merr formë të prerë ditën e shtunë, ne do të kërkojmë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga ana juaj që kërkesën për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit ta shijmë për një moment të dytë. ndoshta për ditën e hënë, duke qenë se e hëna është mundësi për ne, që nga gjykata të tërheqim vendimin e formës së prerë dhe të jemi konform të gjitha rregullave, neneve dhe pikave që ligji parashikon.

Z. I. Celibashi: Po dakord me kërkesën tuaj për t'ju dhënë mundësi për të marrë vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë ku pasqyrohen të gjitha ndryshimet në organet drejtuese të kësaj partie politike. Dakord! Deri ditën e hënë është afati, sepse pastaj përfundon dhe afati për regjistrimin e koalicioneve. Ne duhet të marrim vendim për regjistrimin e partive politike para ditës së hënë. Dita e hënë është afati i fundit. Mirë, dakord! Atëherë, duke qenë se partitë e tjera kanë paraqitur kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, kanë përmbushur kërkesat e ligjit për këtë rast, vendosim regjistrimin si subjekt zgjedhor të:

- Aleanca Demokracia e Re, me kryetar Edmond Stojku;
- Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, me kryetar zotin Eduart Abazi;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 26.02.2025*

- Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë, me kryetar zotin Rivelino Çuno;
 - Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, me kryetar zotin Krenar Rryçi;
 - Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, me kryetar zotin Gjet Ndoj;
 - Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, me kryetar zotin Gaqo Apostoli;
 - Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, me kryetar zotin Selami Jenishehri;
 - Partia Ardhmëria Shqiptare, me kryetar zotin Emin Subashi;
 - Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, me kryetar zotin Valentino Mustaka;
 - Partia politike “Djathtas 1912”, me organ drejtues “Kolegji Politik”;
- Për Partinë Koalicioni Euroatlantik, vendosëm që të shtyhet shqyrtimi i kësaj kërkesë një ditë tjetër.
- Çështje të tjera nuk kemi? Seanca mbyllet. Faleminderit! Ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

